



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

AA.nr.9/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mr.Sc.Muhamet Rexha, kryetar, Nenad Laziq dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur nga i dënuari Sh. L. nga P., kundër aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht PLK.D. nr.22/24 datë 5.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 23.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të dënuarit Sh. L. nga P., ndërsa, vërtetohet aktvendimi i Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.22/24 datë 5.02.2024.

A r s y e t i m i

Me pjesën e I të dispozitivit të aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht PLK.D.nr.22/24 datë 5.02.2024, refuzohet kërkesa për lirim me kusht e të dënuarit Sh. L., nga P., kurse, me pjesën e II të dispozitivit të tij, kërkesa për lirim me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej 3 (tre) muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Kundër aktvendimit të sipër përmendur, i dënuari Sh. L., me kohë ka paraqitur ankesë për shkak të, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Panelit për Lirim me Kusht, ashtu që i dënuari të lirohet me kusht. I dënuari konsideron se vendimi i Panelit për Lirim me Kusht nuk është i drejtë dhe është në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi që nuk janë vlerësuar mirë dhe nuk janë marrë parasysh të gjitha rrethanat gjatë shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht. Nuk kanë marrë parasysh gjendjen fizike dhe psikike, që nuk i është shqiptuar asnjë masë disiplinore gjatë vuajtjes së dënimit dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë për përsëritjen e veprës penale, se ka ndjekur gjitha programet e rehabilitimit të cilat kanë ndikuar pozitivisht tek ai etj.

Paneli për Lirim me Kusht, në përgjigje të ankesës, qëndroi në konstatimet e paraqitura në vendimin e vet, dhe propozoi që ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet aktvendimi i kundërshtuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të vendimit të goditur, pretendimeve ankimore dhe atyre në përgjigje të ankesës, si dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.466/2022 dt.23.09.2022, Sh. L., është shpall fajtor për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, i gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 vit, 8 muaj dhe me dënim me gjobë në shumë prej 5000-euro. Gjykata e Apelit e Kosovës, e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, me aktgjykimin e saj PAKR.nr.578/22 dt.14.11.2022.

Paneli për Lirim me Kusht, ka shqyrtuar kërkesën e të dënuarit, dosjen e tij, raportin përmbledhës të përpiluar nga Ekipi Profesionist i Shërbimit Korrektues të Kosovës, siç është përcaktuar me nenin 116 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr.08/L-132, etj, dhe ka vërtetuar se data e përfundimit të dënimit është caktuar më dt.7.11.2024, nga llogaritja e dënimit për të dënuarin rrjedh se deri tani i njëjti ka mbajtur 10 muaj, e 28 ditë, ndërsa, i kanë mbetur edhe 9 muaj e 2 ditë. Nga raporti social për të dënuarin konstatohet se i dënuari, ka treguar sjellje të mira, nuk është i angazhuar në punë, ka konstatuar se procesi i risocializimit ka rrjedhur normalisht

dhe mbetet të vlerësohet në faza tjera, nuk është arritur risocializimi i plotë, Paneli për Lirim me Kusht, sikundër rezulton edhe nga arsyetimi i aktvendimit të tij, i ka vlerësuar të gjitha kushtet që parashihen me dispozitën e nenit 11 të Rregullores nr.12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht, si dhe të gjitha kriteret dhe kushtet që përcaktohen me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe ka ardhur në përfundim se, për sa i përket këtij të dënuari, ende nuk është arritur qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal i paraparë me dispozitën e nenit 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 dhe 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, kjo, edhe duke u bazuar në natyrën dhe peshën e veprës penale dhe raportin social të Qendrës Korrektuese , andaj, në rastin konkret Paneli me rastin e vendosjes mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores së sipër përmendur, përkatësisht, se pesha e krimit është një tregues i nevojës për të mbrojtur shoqërinë përmes parandalimit të kryerjes së veprave penale të tilla apo të ngjashme penale, për të cilën arsye, Paneli për Lirim me Kusht, e refuzoi kërkesën e të dënuarit për periudhën kohore prej 3 (tre) muaj dhe se e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Duke u nisur nga gjendja e këtillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës e pranon si të bazuar qëndrimin juridik të Panelit për Lirim me Kusht, përkitazi me refuzimin e kërkesës për lirim me kusht të dënuarit Sh. L., me të dhënat si në dispozitivin e aktvendimit të tij, pasi që, aktvendimi i Panelit nuk është përfshirë me shkelje ligjore, të dispozitave procedurale dhe materiale, nga se dispozitivi i aktvendimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin e tij, kurse, në arsyetim janë dhënë arsyet e mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, ndaj, konsideron se pretendimet ankimore lidhur me shkeljet e pretenduara, nuk mund ta vënë në pyetje aktvendimin e goditur të sipër përmendur të Panelit për Lirim me Kusht.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Paneli për Lirim me Kusht, përkitazi me vendosjen e rastit konkret, ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e nenit 38 par.1, pikat 1.1 deri 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ku veç tjerash, në kuadër të qëllimit të dënimit, parashihet; të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale etj, sikundër që, ka zbatuar drejtë edhe dispozitat e nenit 5 dhe 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, që kanë të bëjnë me qëllimin e ekzekutimit të sanksioneve penale, si aspekti i risocializimit, i ri integritetit të dënuarit në shoqëri, përgatitjen e tij për jetë dhe për sjellje të përgjegjshme etj. Në

këtë kontekst, Paneli për Lirim me Kusht, ka pasur parasysh, dhe ka zbatuar drejtë edhe dispozitat e Rregullores së KGJK-së, për Punën e Panelit për Lirim me Kusht nr.12/23, përkatësisht, nenit 15, nenit 11 të saj, që kanë të bëjnë me peshën e krimit, historinë e kaluar kriminale, përshkrimi i personit të dënuar për krimin, sjellja e tij gjatë burgimit, gjendja psikiatrike apo psikologjike, gjendja fizike, ekzistenca e një rreziku të përgjithshëm për publikun, planet e personit të dënuar pas lirimit etj, ndaj, nga këtu, edhe kjo Gjykatë, vlerëson se Paneli për Lirim me Kusht, kur ka vendosur për refuzimin e kërkesës së të dënuarit për lirim me kusht, për periudhën 3 mujore, me mundësinë e rishqyrtimit të saj, pas kalimit të këtij afati, ka marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Për arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 117 par. 11 dhe 12 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr.08/L-132, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
AA.nr.9/2024 datë 23.02.2024

Kryetar i kolegjit  
Mr.Sc.Muhamet Rexha